



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2781

Nr. _____ Prot

2307

Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.32

Datë: 22.07.2025.

“Për emërtimin e rrugëve, shesheve, territorëve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë: “Emërtimi i Qendrës Shëndetësore Sllovë në emrin “Xhavit Daci””

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.32 Datë 22 / 07 /2024

“Për emërtimin e rrugëve, shesheve, territorëve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë: “Emërtimi i Qendrës Shëndetësore Sllovë në emrin “Xhavit Daci””

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9/1.7 gërma “b” dhe nenit 54, gërma “ll”, neni 55 pika 2 të ligjit nr.139/2015, për “Vetëqeverisjen Vendore”, Këshilli Bashkiak mori në shqyrtim propozimin e bërë nga Njësia Administrative Sllovë për emërtimin e Qendrës Shëndetësore Sllovë me emrin e te ndjerit Xhavit Daci ,mjek i zonës dhe i rënë në krye të detyrës. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **22.07.2025** me 16 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e Qendrës Shëndetësore Sllovë me emrin Qendra Shëndetësore Xhavit Daci.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Dibër, Drejtoria e Shërbimeve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall me datë **22.07.2025**

Kryetare e Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur është adresuar Bashkisë Dibër nga _____ dhe mban nga dërguesi nr. 22 prot. _____
datë. 10.03.2025 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) _____

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot. 1067 datë 10.03.2025

Praktika u kryejtohet për administrim:

-Znj/Z _____

-Znj/Z Leke Jonit të Famillet Bashke

-Znj/Z _____

-Znj/Z _____

me porosinë: _____

Admonistruar praktikën sipas l. p. t.

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë _____

Sipas ofatave

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: _____

Peshkopi, më 10.03.2025

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]

1067
17/03/25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
NJËSIA ADMINISTRATIVE SLOVË

Nr 22 Prot

Peshkopi, më 10 / 03 / 2025

Lënda: Propozim për vendosje emri Qendrës Shëndetësore Slovë.


Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër

Njësia Administrative Slovë bazuar në kontributin e dhënë nga i ndjeri Xhavit Mehdi Daci si mjek pranë ish spitalit të Slovës, sot Njësia Administrative Slovë dhe rëndësinë e tij në krye të detyrës propozojmë:

Qendra Shëndetësore Slovë nga emërtimi i tanishëm "Qendra Shëndetësore Slovë" të marrë emërtimin Qendra Shëndetësore Xhavit Daci Slovë"

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ADMINISTRATORI
Ardian XHOKA



Xhavit Mehdi Daci lindi më 21 mars 1940 në fshatin Zall-Kalis, Lokaliteti Sllovë/Shkollën 7-vjecare e kreu në Sllovë me rezultate të shkëlqyera. Pas Shkollës 7-vjecare ai vazhdoi shkollën e mesme në Politekniumin Mjekësor në Tiranë dhe më vonë kreu studimet e larta në Fakultetin e Mjeksisë Tiranë.

Në janar të vitit 1966 filloi punë në spitalin e Sllovës ku për disa vite kreu detyrën e drejtorit të këtij institucioni. Pranë këtij spitali Xhaviti punoi për 10 vite me radhë ku u karakterizua nga korrektësia dhe përkushtimi në punë ditën dhe natën jo vetëm në zënnën e Sllovës por deri në Kala të Dodës, në Kalis dhe Vilë të Kukësit. Më 31 gusht 1976 transferohet në spitalin e Reçit.

Me datë 29 dhjetor 1978 Xhaviti duke shoqëruar me ambulancë një të sëmurë (Mehmet Meçi, sot doktor i shkencave) si pasojë e një aksidenti nga moti i keq me datë 31 dhjetor 1978 megjithë ndihmën e kolegëve të spitalit të Peshkopisë ndahet nga jeta në krye të detyrës (kjo edhe sipas librezes së tij të punës) duke lënë pas katër vajza në moshë të vogël, ku më e vogla ka lindur pas vdekjes së tij.